



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:236551
Datë: 13.11.2024
Numri i dokumentit: 06445302

C-IV-13-2866

Ankuesi

Këshilli i Bashkësisë Islame, Prizren.
Përfaqësuar nga R B avokat nga Prizreni.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 11 nëntor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- APROVOHET** ankesa si e bazuar dhe **ndryshohet** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. PRZ041-0897 datë 04 tetor 2013.
- OBLIGOHET** e paditura AKP që ankuesit **Këshilli i Bashkësisë Islame** në Prizren në emër të pagesës për borxhin e qirasë, për lokalin me adresë në rr. “1 Maji” p.n. në periudhën kohore prej 1 janar 1992 – 30 nëntor 1992 nga NSH “Liria” në Prizren (*në likuidim*), t’i paguaj **shumën prej 4,081.11 €**, si dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t’i paguaj **shumën prej 408.11 €**.
- Shumat e aprovuara si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.
- OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej **100.00 €**.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 31 tetor 2013, përfaqësuesi i autorizuar i ankuesit dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PRZ041-0897 i datës 04 tetor 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin i ishte refuzuar si e pavlefshme nga AL kërkesa për pagesë për borxhin e qirasë, për lokalin e NSH “Liria” në Prizren, me adresë në rr. “1 Maji” p.n. në periudhën kohore prej 1 janar 1992 – 30 nëntor 1992

në shumë prej 4,081.11 €. Përfaqësuesi i ankuesit theksoi se me vendimin e kundërshtuar në fjalë, kërkesa është refuzuar si e pavlefshme, duke konsideruar se e njëjta është parashkruar në bazë të nenit 379 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), pasi që nga data e marrjes së aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren AC. nr.142/93 datë 26 prill 1993, në të cilën mbështetet kërkesa, gjatë periudhës kohore prej 10 vitesh ankuesi nuk ka bërë asnjë kërkesë për ekzekutim të këtij aktgjykimi. Në lidhje me këtë, përfaqësuesi i ankuesit thekson se të paraqiturat e sipërsënuara në arsyetimin e vendimit të kundërshtuar të AL lidhur me parashkrimin e kërkesës janë në tërësi të pabazuara, nga këto arsye: Kërkesa e paraqitur mbështetet në aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës së Qarkut në Prizren AC. (GZ) 142/93 datë 26 prill 1993, me të cilët është detyruar NSH “Liria” në Prizren, në emër të qirasë t’i paguaj ankuesit kundërvlerën në dinar për shumën prej 4,400.00 DM. Duke pasur parasysh faktin se NSH-ja, nuk e ka përmbushur detyrimin nga aktgjykimi i sipër shënuar brenda afatit të caktuar, Këshilli i Bashkësisë Islame në Prizren me 24 maj 1993 në Gjykatën Komunale në Prizren, ka paraqitur propozimin për ekzekutim, i cili ekzekutim edhe është caktuar me vendimin e asaj gjykate E.nr.283/93 datë 08 qershor 1993. Për një kohë të gjatë, nga shkak se menaxhues dhe udhëheqës të NSH-së, deri në përfundim të bombardimeve nga NATO, kanë qenë pjesëtar të nacionalitetit serb, edhe pse është caktuar ekzekutimi qysh me 08 qershor 1993, ai asnjëherë nuk është filluar e as përfunduar deri më sot. Në ndërkohë, pas përfundimit të luftës së fundit në Kosovë, duke pasur parasysh faktin se është ndërruar mjeti i pagesës nga dinari në DM e pastaj në euro, nga “C&M – Bussines” në Prizren, është bërë revalorizimi i shumës së gjykuar me aktgjykimet e më sipërme, sipas së cilës ekspertizë borxhi është caktuar në lartësi 4,145.00 €. Pas udhëheqjes për një kohë të gjatë të procedurës së ekzekutimit në Gjykatën Komunale të Prizrenit, pas themelimit të DHPGJS dhe ndryshimeve të mëvonshme ligjore, lënda e ekzekutimit është përcjell nga Gjykata Komunale e Prizrenit në kompetencë të DHPGJS. Deri më sot nuk ka kurrfarë informate për fatin e kësaj lënde dhe shumë lëndëve tjera mes këtyre palëve. Siç shihet të pabaza janë konstatimet në arsyetimin e vendimit të kundërshtuar të AL, se ankuesi nuk ka bërë asnjë kërkesë për ekzekutim të vendimit gjyqësor në periudhën kohore prej 10 vitesh nga data e ekzekutueshmërisë së aktgjykimit në të cilin mbështet kërkesa. Aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm me 26 prill 1993, kur është marr aktgjykimi Ac.nr.142/93 në shkallë të dytë. Propozimi për ekzekutim është paraqitur me 24 maj 1993 e aktvendimi sipas propozimit E.nr.283/93 është marr me 08 qershor 1993. Kjo nënkupton se propozimi për ekzekutim është paraqitur menjëherë brenda një muaji e jo pas 10 vitesh, si pretendon AL me vendimin e kundërshtuar, rishqyrtimi i të cilit kërkohet ashtu që propozimi për ekzekutim është paraqitur brenda afatit të caktuar ligjor. Në këtë mënyrë fjala është për realizimin e një të drejte të pranuar me aktgjykim të plotfuqishëm të gjykatës nga e cila arsye edhe në vendimin e AL gabimisht është zbatuar dispozita ligjore nga neni 379 i LMD. Afati i kaluar pas paraqitjes së propozimit për ekzekutim deri në vendosje nga gjykata nuk ka kurrfarë ndikimi në realizimin e kërkesës, pavarësisht sa është ai, pasi që në bazë të Nenit 388 të LMD i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të kësaj marrëdhënie juridike dhe nenit 369 të LMD në fuqi, parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e ankesës dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarr kundër debitorit para gjykatës me qëllim të realizimit të kërkesës. Nga kjo, qysh nga 24 maj 1993 kur është paraqitur propozimi për ekzekutim është ndërpre rrjedha e afatit të parashkrimit. Ankuesi i propozon gjykatës që të miratoj kërkesën për pagesën e borxhit nga NSH, në lartësi prej 4,145.90 € me kamatë ligjore nga 06 shtator 2004 kur është bërë ekspertiza. Ankuesi në mbështetje të ankesës së

tij ka bashkangjitur vendimin e kundërshtuar dhe dëshmitë në kopje si: Propozimin për Ekzekutim nr. 283/93 datë 8 qershor 1993, Ekspertizën (Llogaritjen e valorizimit) nr. 4/2004 datë 06 shtator 2004 dhe autorizimin për përfaqësim nr. 781/13 datë 1 nëntor 2013.

Me 19 qershor 2014, e paditura parashtrroi mbrojtjen e saj, në të cilën pohoi se vendimi i AL saktësisht ka zbatuar rrethanat faktike dhe është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, prandaj bazuar në argumentet e mëposhtme ankesa është e pabazuar. E paditura konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin 04/L-034) e vendimit të AL dhe vetëm kjo. Në këtë kontekst, neni 70.2 i Ligjit 04/L-033 përcakton që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL gjatë marrjes së vendimit dhe si rrjedhojë nuk ka respektuar nenin 70.2 të Shtojcës së Ligjit 04/L-033, i cili parashihet se ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Prandaj, sipas qëndrimit të vet parashtruesit, vendimi nuk ka shkelur asnjë dispozitë ligjore të Ligjit 04/L-034 dhe kështu nuk ekziston asnjë bazë ligjore për ta shfuqizuar atë. Rrjedhimisht, në zbatim të Nenit 70.2 të Shtojcës së Ligjit 04/L-033, kjo ankesë është e pabazuar. E paditura, pohon se kërkesa është parashtruar jashtë afatit për parashtrimin e kërkesave, e që data është 31 korrik 2013 dhe në lidhje me këtë nuk është dorëzuar asnjë justifikim bindës. E paditura më tej thekson se kërkesa është e parashkruar dhe se parashtruesi nuk e ka kuptuar dhe ka gabuar në llogaritjen e parashkrimit duke pretenduar se propozimi për ekzekutim është paraqitur me 24 maj 1993 ndërsa vendimi sipas këtij propozimi E.nr.283/93 është marr me 08 qershor 1993, ndaj kërkesa nuk mund të jetë parashkruar për një muaj. Parashkrimi prej 10 vitesh parashikuar nga neni 379 i LMD fillon të llogaritet nga data 08 qershor 1993 kur gjykata ka lëshuar vendimin me E.nr. 283/93 i cili i ka dhënë të drejtë parashtruesit dhe kërkesa konsiderohet e parashkruar me 08 qershor 2003. Pra ndryshe nga sa pretendon parashtruesi, parashkrimi i parashikuar nga neni 379 i LMD nuk fillon të llogaritet nga momenti i dorëzimit të ankesës apo çdo lloj kërkesë në gjykatë por nga momenti që kjo e fundit ka vendosur mbi këtë ankesë / kërkesë. Në çdo rast dhe nëse pranojmë që parashtruesi me anë të propozimit për ekzekutim datë 24 maj 1993 ka ndërprerë parashkrimin, kjo nuk do të thotë se ndërprerja vazhdon përgjithmonë por se një afat i ri parashkrimi fillon nga kjo datë (neni 392 i LMD i cili parashikon se sa herë parashkrimi ndërpritet, afati i ri i parashkrimit fillon të rrjedhë përsëri). Për sa i përket pretendimit të parashtruesit se neni 388 i LMD-së parashikon se parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e padisë ose çdo veprim të kreditorit para gjykatës, e paditura sërish konsideron se parashtruesi ka gabuar duke cituar dispozitat e LMD-së në mënyrë të shkëputur nga njëra – tjetra dhe jo duke i parë ato në lidhje dhe vazhdimësi logjike me njëra – tjetrën. Duke parë nenin 388 të LMD-së në lidhje me nenin 379, është e qartë se parashkrimi fillon të rrjedhë nga momenti që kërkesa e dorëzuar nga kreditori pranohet ose refuzohet me një vendim të formës së prerë dhe konsiderohet e parashkruar 10 vite pas këtij momenti. Në fund, e paditura thekson se kuptimi i institutit të parashkrimit është që disa të drejta vjetërsohen me kalimin e afateve të parashikuara nga ligji sepse nëse palët do të pretendonin të drejta të përfituara para 60 vitesh (p.sh.) do të cenohej siguria juridike në marrëdhëniet mes palëve dhe për më tepër me kalimin e kohës vështirësohet gjetja e provave që vërtetojnë ekzistencën ose mos ekzistencën e fakteve. E

paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të pabazuar dhe të vërtetoj vendimin e AL në pajtim me Nenin 70.4 të Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-033. Në mbështetje të saj ka bashkangjitur dëshmitë në kopje si: Vendimin për fillimin e likuidimit dhe emërimin e anëtarëve të AL nr. DM 53/2013 datë 10 qershor 2013 dhe disa dëshmi për publikimin e njoftimit në gazeta ditore në lidhje me afatin për dorëzimin e kërkesave.

Me 01 gusht 2014, përfaqësuesi i autorizuar i ankuesit dorëzoi përgjigjen e tij ndaj mbrojtjes. Me 09 shtator 2014, e paditura dorëzoi kundërpërgjigjen e saj.

Për detaje tjera referimi mund bëhet tek dosja e lëndës.

Arsyetimi ligjor

Ankesa aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në lidhje me pretendimin e të paditurës të parashtruar në mbrojtjen e saj se kërkesa në procedurë të likuidimit është dorëzuar jashtë afatit për parashtrimin e kërkesave, gjykata konsideron se është i pabazuar, kjo pasi në vendimin e kundërshtuar veçse është konstatuar se kërkesa është dorëzuar brenda afatit për parashtrimin e tyre në procedurë të likuidimit (datë 1 gusht 2013), andaj një pretendim i tillë, me këtë rast refuzohet.

Ankuesi ka kundërshtuar vendimin e AL nr. PRZ041-0897 datë 04 tetor 2013, me të cilin vendim ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për pagesë për borxhin e qirasë, për lokalin me adresë në rr. “1 Maji” p.n. në periudhën kohore prej 1 janar 1992 – 30 nëntor 1992 në shumë prej 4,081.11 € nga NSH “Liria” në Prizren (*në likuidim*). Nga ankesa del se ankuesi në emër të kërkesës në fjalë tani kërkon shumën prej 4,145.90 €. Gjykata konstaton se objekt shqyrtimi i ankesës është vetëm vendimi i kundërshtuar përkatësisht lartësia e kërkesës e shqyrtuar në procedurë të likuidimit tek e paditura, andaj pjesa tjetër e kërkesës përtej shumës prej 4,081.11 €, nuk do të merret në shqyrtim.

Ankuesi, bazën e kërkesës së tij për pagesë për borxhin e qirasë, për lokalin me adresë në rr. “1 Maji” p.n. në periudhën kohore prej 1 janar 1992 – 30 nëntor 1992 në shumë prej 4,081.11 €, nga NSH “Liria” në Prizren, e mbështet në Aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Prizren C. (P) nr. 1691/92 datë 30 dhjetor 1992, Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Prizrenit Ac. nr. 142/93, datë 26 prill 1993 dhe Propozimin për Ekzekutim të Gjykatës Komunale në Prizren, i cili ekzekutim është caktuar me aktvendimin E. nr. 283/93 datë 08 qershor 1993, Ekspertizën (Llogaritjen e valorizimit) nr. 4/2004 datë 06 shtator 2004 si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë dhe në përgjigjen e tij në mbrojtje. Andaj, gjykata i vlerëson dhe i pranon si prova relevante dëshmitë në fjalë si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë dhe në përgjigjen e tij në mbrojtje, për të konstatuar se ankuesi ka të drejtë në kërkesën e tij për kompensim të borxhit të qirasë sipas aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren dhe Propozimit për Ekzekutim të Gjykatës Komunale në Prizren E. nr. 283/93 datë 08 qershor 1993. Sa i përket lartësisë së kërkesës, gjykata e ka aprovuar shumën e kërkuar në procedurë të likuidimit nga ankuesi, shumë e cila rrjedh nga Ekspertiza nr. 04/2004 datë 6 shtator 2004 dhe meqenëse e njëjta nuk është kontestuar nga e paditura, gjykata e aprovon plotësisht shumën e borxhit të qirasë, në lartësinë e kërkuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 408.11 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera të palëve dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Ankuesi kishte dorëzuar një kërkesë brenda afateve në AL me 1 gusht 2013. Gjykata vlerëson se, në kuptim të nenit 379 të LMD-së (1978) afati i parashkrimit nga kërkesat e vendosura me aktgjykim të gjykatës është 10 vjeçar dhe kësaj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Pasi është bërë i plotfuqishëm aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren C. (P) nr. 1691/92 datë 30 dhjetor 1992 dhe në lidhje me ekzekutimin e tij është parashtruar propozimi për ekzekutim si dhe fakti që ekzekutimi është caktuar me aktvendimin E. nr. 283/93 datë 08 qershor 1993, por nuk është realizuar gjer në shqyrtimin e kësaj kërkesë në procedurë të likuidimit,

gjykata konsideron se këto rrethana e kanë ndërprerë parashkrimin në kuptim të dispozitave të LMD përkatësisht nenit 388 të LMD 1978 (ligj atëherë në fuqi) apo nenit 369 të LMD aktualisht në fuqi.

Në lidhje me pretendimin e të paditurës për rrjedhjen e afatit të ri të parashkrimit përkatësisht pohimit se prej më shumë se 20 vitesh nga data që vendimi është marr dhe deri në ditën që ka dorëzuar kërkesën në procedurë të likuidimit (më 1 gusht 2013), ankuesi nuk ka ndërmarr asnjë veprim për të kërkuar që të drejtat e tij të ekzekutohen, gjykata konsideron se ky pretendim nuk qëndron. Ankuesi ka ndërmarr veprimet e duhura duke përfshirë iniciimin e procedurës së ekzekutimit të aktgjykimit në Gjykatën e atëhershme Komunale në Prizren dhe gjithashtu në periudhën e pas-luftës duke dorëzuar kërkesën e tij kreditore në procedurë të likuidimit brenda afateve të përcaktuara nga vet e paditura pasi NSH është fut nën administrim të të paditurës, përkatësisht pasi procedura e likuidimit ka filluar ndaj NSH-së. Prandaj, gjykata vlerëson se në këtë rast nuk mund të zbatohet neni 392 i LMD (1978).

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e paditura AKP si palë e pasuksesshme, obligohet ti paguaj ankuesit shpenzimet e procedurës dhe atë për taksën gjyqësore në shumë prej 100.00 €.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar